



**No
risk,
no
fun?**



Të rinjtë e rrezikuar në komunikacionin rrugor.

Çka mund të bëjnë prindërit.

Tejkalimi i kufijve, Dehja, Aksidentet, Provokimet

Ndalimet vlejné po aq pak sa edhe shprehja e shqetësimit! Prandaj, si duhet të reagojnë prindërit në mënyrën më të përshtatshme?

Vozitja e automjeteve pa patentë shoferi bëjnë që me 12,3% e të gjitha aksidenteve të rënda në komunikacion, të rinjtë 16 deri 18 vjeç të jenë pjesa më e prekur e aksidenteve të rënda. Në krahasim me aksidentet e tjera, të rënda, aksidentet e kryera nga të rinjtë e moshës 16 deri 18 vjeç, ndodhin gjatë vozitje së automjetit pa patentë shoferi, kryesisht natën si dhe shpesh aksidente të vet shkaktuara.

Prindërit nuk duhet t`i paguajnë në asnjë mënyrë dënimet dhe gjobot e të rinjve të tyre kundërvajtës. Këshillohet po ashtu që, pjesën më të madhe të shpenzimeve për marrjen e patentë shoferit, ta marrin vet të rinjtë.

Ju si prindër keni mundësi ndikimi! Përdoreni këtë – në të dobi të fëmijës suaj!





Sjellja e rrezikshme/Kompetencat në rast rreziku

A e keni ditur se...


...Tejkalimi i kufijve (Droga, Seksi, Dhuna) në moshë të re ndodhin shpesh?

...mundësia, që një i ri para moshës 20 vjeçare të vdes nga një aksident është 4 herë më i madh sesa të një vajze?

...Të rinjtë në grupe janë të shtyrë që t`i tejkalojnë kufijtë e tyre?

Çka mund të bëni Ju?

Në rast se djali juaj e kërkon rrezikun: jepjani mundësinë, që të mësohet se si të sillet me te (Alpinizmi, vozitja Go-Kart , hedhje nga trampolina, Trial, Parkour, si dhe sportet ekipore etj.) – nën udhëheqjen e personit me përvojë profesionale. Ju nuk mund ta parandaloni rrezikun, por mund të jepni njohuri se si të sillet në rast rreziku



Komunikacioni rrugor

A e keni ditur se ...

...shkaku më i shpeshtë i vdekjes së nxënësve në moshën prej 13 deri 15 vjeç është komunikacioni rrugor ?

...në shumicën e aksidenteve, shkaktar janë Alkooli ose Drogat e tjera ?

...shpesh janë të prekur edhe bashkudhëtarët?

Çka mund të bëni Ju?

Ju jeni shembull: vetëm prindërit, që sillen vet në komunikacion sipas rregullave të parapara, me kujdes dhe vetëdije të sigurt, janë ambasador (përcjellës) të besueshëm preventiv.

Shtjelloni tema vazhdimisht rreth rrezikut në komunikacionin rrugor dhe veni në pah sjelljet e rrezikshmërisë. Inkurajoni djalin tuaj që të merr përgjegjësinë për veten e tij si dhe ambientin që e rrethon.



Vozitja e egër e automjetit

A e keni ditur se...

...Vozitja e egër e automjetit* shumë shpesh përfundon me aksidente ose me lëndime?

... Ju, si mbajtës i automjetit, në rast të vozitjes së egër ju bënë përgjegjës?

...çdo vit mbi 30 të rinj lëndohen rëndë si pasojë e vozitjes së egër të automjetit?

...shpesh aksidentet përfundojnë me vdekje

...90% të këtyre vozitësve janë djem të rinj?

Shumica e tyre në këtë rast vjedhin automjetet ose motoçikletat e prindërve ose të njohurve të tyre për t'i përdorur ato. Prindërit shpesh kësaj sjellje nuk i japin rëndësinë e duhur.

* Vozitja me automjet të vjedhur (shpesh pa patentë shoferi)

Çka mund të bëni Ju?

Mos i mësoni djalit tuaj vozitjen e automjetit para kohe. Të rinjtë shumë shpejt mendojnë se dinë ta vozisin automjetin. Në rast se djalit tuaj i keni mësuar vozitjen e automjetit-atëherë bëjani me dije se ushtrimi në një vend parkimi nuk ka të bëjë me vozitjen reale.

Besojani fëmijës suaj parimisht – që marrja e çelësve të automjetit për disa të rinj është një tundim i madh – Ju si mbajtës i automjetit ju bënë përgjegjës!

Njoftojeni fëmijën tuaj me bazat ligjore – edhe bashkudhëtarët janë bashkë përgjegjës! Përcilljani fëmijës suaj, në mënyrë reale, se cilat janë pasojat e një momenti të pa menduar mirë. Duke i dhënë në dorë automjetin një të riu, ju i keni vënë atij në dorë një "Armë" vrasëse. Është ai mjaftë i pjekur për këtë?

Oferta të tjera

Ne ofrojmë referate për shoqata prindërisht. Ju mund të motivoni arsimimin për prindër në komunën tuaj, një arsye më shumë për zbatimin e kësaj teme. Propozoni shkollës së fëmijës suaj, të shtjellojnë tema rreth sjelljeve të rrezikshme. Projekti «Speed» ofron material mësimor si dhe shkollim të mëtutjeshëm për mësime të mësimdhënësit.

Këto oferta janë të financuara nga fondi për siguri në komunikacion, dhe ju ofrohen falas.

Këshilla, informata ose udhëzime: Netzwerk Schulische Bubenarbeit NWSB
Postfach 101 | 8117 Fällanden | Tel. 044 825 62 92 | www.nwsb.ch
www.ist-rasen-maennlich.ch | www.speedtest09.ch | www.bfu.ch | www.roadcross.ch

